Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Lulzim Bajrami	**07.12.2023**	**08.12.2023**	**2023/0935**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 24.11.2023, **OE "N.T.SH." CREATIVE DESIGN** ""- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0935, kundër për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "**"Rroni" Sh.p.k.- Prishtinë,** apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me emblema per Njesine Speciale - ritender" me nr. të prokurimit: "214-23-11565-1-3-6", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS**. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurene koutimit te qmimit, vlera e parashikuar e kontrates **9,930.00 €.**Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së Neni 7 i LPP-së Neni 59 i LPP-së Neni 60 i LPP-së Neni 69 i LPP-së.

Njoftimi për Kontratë është bërë me dt. 23.10.2023, kurse hapja e ofertave është bërë me dt. 30.10.2023 , ku kanë qenë 3 ofertues . Njoftimi mbi vendimin e AK-së është publikuar me dt. 06.11.2023 ku është rekomanduar për kontratë për RRONI SH.P.K., kurse neve na është dërguar letra standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin si në vijim: "Ju nuk i plotësoni specifikimet teknike tek Aneksi 1 si në vijim:

a) Në aneksin 1 specifikat teknike të detyrueshme te pozicioni LOGO K-9 është kërkuar-

Fillimi i rrethit të emblemës me ngjyrë të kaltërt e mbyllët – Operatori ekonomik mostrën e dorëzuar për LOGO k-9 është me ngjyrë te. Sipas kësaj ky operator ekonomik nuk i plotëson specifikat e kërkuara në dosjen e tenderit dhe eliminohet si ofertë e papërgjegjshme".

Fillimisht ju sqarojmë se arsyeja e autoritetit kontraktues është e paqartë dhe e pakuptueshme për ne për faktin se në arsyetimin e eliminimit nuk shënohet fare se çfarë gabimi ka mostra jonë. AK-ja e ka cekur se – Operatori ekonomik mostrën e dorëzuar për LOGO k-9 është me ngjyrë te, duke mos e specifikuar fare se çfarë ngjyre e kemi prezantuar në mostrën e kërkuar.

Ne ju sqarojmë se mostra jonë është prezantuar në ngjyrën e kërkuar pra ngjyrë e kaltërt e mbyllët, ashtu siç është specifikuar tek specifikimet teknike të detyrueshme. Përderisa nuk është specifikuar qartë arsyeja e AK-së për eliminimin tonë, kuptohet qartë se ne i përmbushim të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe specifikimet teknike të detyrueshme, pasi që nëse do të ishim të papërgjegjshëm, AK-ja do ta sqaronte me fakte dhe argumente konkrete një gjë të tillë.

Tani në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK-ja e ka cekur se kinse ngjyra e llogos është prezantuar me ngjyrë të zezë, mirëpo edhe një herë po e sqarojmë se ngjyra e mostrës sonë të cilën e kemi dorëzuar është me ngjyrë të kaltër të mbyllët ashtu siç është kërkuar tek specifikimet teknike. Duhet cekur fakti se në këtë aktivitet të prokurimit AK-ja përdorur standarde të dyfishta ku e ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm, ndërsa na ka eliminuar neve me arsyetime krejtesisht të pa bazuara. OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktet si në vijim:

1.Logo e NJSI

Mostra e kerkuar nga AK

Diametri 8 cm

Krahi duhet të jetë i qendisur

Të lëtë pjesën tjetër mbrapa VELCRO për fiksim në uniformë .

Emblema të jetë e thurur/ndërlidhur sipas dizajnit me ngjyrë dhe përshkrimit në foto.

Ngjyrat në Amblem janë: Ngjyra e gjelbër. (Ushtarake), Ngjyra e Zezë,Ngjyra e Kuqe, Ngjyra e Hundës

Mostra e ofruar nga OE I rekomanduar

PRETENDIMET ANKIMORE

Logo NJSI nuk eshte as per se afermi e njejte me ate te cilen e ka kerkuar AK.
- Dimensioni nuk eshte 8cm
- Ngjyrat nuk jane sikur ne foto
- Shkronjat " SPECIAL INTERVENTION UNIT" nuk kane madhesine sipas mostres se kerkuar nga AK

Kur analizohet në tërësi mostra e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë, atëherë shihet qartë se mostra e të njëjtit as për së afërmi nuk është e njëjtë me mostrën që ju si autoritet kontraktues e keni kërkuar. Në fotot e lartcekura ne i kemi vendosur disa nga dallimet ndërmjet mostrës së OE të rekomanduar për kontratë dhe mostrës së kërkuar nga ju dhe shumë lehtë vërehen gabimet tek mostra e OE të rekomanduar për kontratë.

Fillimisht ngjyra nuk është e njëjta sikurse në fotografi, përkatësisht nuk është prezantuar sipas kërkesës tuaj. 6/4 Gjithashtu dimensioni i kërkuar prej 8cm ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit nuk është prezantuar sipas kësaj kërkese, pasi që mostra e OE të rekomanduar për kontratë nuk është prezantuar në dimensionin e kërkuar. Andaj nga ky fakt kuptohet qartë se i njëjti OE është i papërgjegjshëm dhe nuk është dashur të rekomandohet për kontratë. Shkronjat "SPECIAL ITERVENTION UNIT", sipas kërkesës së autoritetit kontraktues nuk, në mostrën e OE të rekomanduar për kontratë nuk janë sipas kërkesës dhe në këtë rast ky OE është i papërgjegjshëm.

LOGO NJSO:

2.Logo e NJSO

Mostra e kerkuar nga AK

Mostra Obligative, Çmimi 3 Euro copa

Diametri 8 cm

Trethi duhet të jetë i qendisur

Të ketë pjesën tjetër mbrapa VELCRO për fiksim në uniformë .

Emblema ti jetë e thurur/ndërlidhur sipas dizajnit me ngjyrë dhe përshkrimit në foto.

Ngjyrat në Amblem janë: E Kaltër e Mbyllët(Teget), E Zezë , E Hirit, Ngjyra e verdhë

Mostra e ofruar nga OE i rekomanduar

PRETENDIMET ANKIMORE

- Dimensioni nuk eshte 8cm
- Shqipnjat nuk jane te qendisura sikur mostra e AK
- Fonti i shkronjave nuk eshte i njejte sikur mostra e AK

Sikurse e cekëm më lartë edhe në këtë rast mostra e OE të rekomanduar për kontratë nuk është prezantuar sikurse që është kërkuar, pra nuk është as për së afërmi e njëjtë me mostrën e kërkuar nga ana juaj. Mostra e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë në lidhje me dimensionin e kërkuar prej 8cm ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit nuk është prezantuar sipas kësaj kërkese, pasi që i njëjti OE nuk e ka prezantuar mostrën në dimensionin e kërkuar. 8/4 Llogoja e shqiponjës nuk është fare e njëjtë me llogon e vendosur tek mostra e prezantuar nga ana juaj si autoritet kontraktues.

Gjithashtu edhe fonti i shkronjave në mostrën e OE të rekomanduar për kontratë, ka dallime esenciale, në krahasim me mostrën e autoritetit kontraktues, andaj në lidhje me produktin e lartcekur OE i rekomanduar për kontratë nuk e përmbush fare kërkesën e dosjes së tenderit përkatësisht kërkesat tek specifikimet teknike të detyrueshme.

3.Logo e IEDD

Mostra e kerkuar nga AK

Mostra e ofruar nga OE i rekomanduar

Dimension 8 cm

Prapavija e logos ngjyre e kaltër e mbylleë

Harta e Kosovës ngjyre hiri

Akrepi (shqipon) i ngjyre te verdh me te zeze

Granata e dorës ka ngjyre të ba dhe me te zeze

Shkronjat (mad shkrimi) janë me ngjyre te bardhe

Per metri(rrethi) I jashtëm është me ngjyre hiri

Rrethi duhet te jete qendisur

Të ketë gjesën tjetër mbrapa VELCRO per fiksim në uniformë .

Emblema të jetë e thurur/nderidhur sipas dizajnit me ngjyrë dhe përshkrinit në foto.

PRETENDIMET ANKIMORE

- **Dimensioni nuk eshte 8cm**
- **Forma e emblemes nuk eshte e rrumbullaket**

Sikurse edhe në pretendimet e lartcekura edhe tani për produktin e lartcekur përkatësisht për Llogon e IEDD, OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar mostrën, jo sipas specifikimeve teknike të kërkuara tek aneksi 1 i dosjes së tenderit. Mostra e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk është prezantuar me dimensionin e kërkuar, pasi që është kërkuar që mostra të jetë 8 cm, ndërsa mostra e OE të rekomanduar për kontratë e tejkalon madhësinë e kërkuar.

Gjithashtu edhe forma e mostrës nuk është në formë të rrumbullakët, ashtu siç e keni prezantuar ju si AK mostrën, mirëpo është krejtësisht ndryshe nga mostra e autoritetit kontraktues. Po ashtu edhe figura e Akrepit nuk është prezantuar në mostër sipas, mostrës së prezantuar nga ana e autoritetit kontraktues dhe si përfundim i njëjti OE është i papërgjegjshëm edhe për këtë fakt.

4.Logo e K-9

Mostra e kerkuar nga AK

Mostra e ofruar nga OE I rekomanduar

Materiali i beritë punuar me kompjuter i qëndisur me penj të holle dhe me ngjyra të ndryshme

Fillimi i rrethit të emblemës me ngjyrë të kaltër e mbyllë

Shkronjat me të bardha

Hapësira jashtë hartës së Kosovës me ngjyrë të zezë

Harta e Kosovës me ngjyrë të hirit e qelltë

Fotografia e qenit të punohet me ngjyr të zezë dhe kafe , gjuha e kuqe si në foto

dimensioni i emblemes 8 cm

Në emblemë të shkruhet KOSOVO POLICE -SPECIAL UNIT kurse poshtë K-9

Rrethi duhet të jetë I qendisur

<u>Të ketë pjesën e tetë mbrapa VELCRO</u> per ngasim me uniforme .

<u>Emblema të jetë e thurur/ndërlidhur sipas dizajnit me ngjyrë dhe përshkrimit në foto.</u>

PRETENDIMET ANKIMORE

Logo K-9 nuk eshte as per se afermi e njejte me ate te cilen e ka kerkuar AK.
- Dimensioni nuk eshte 8cm
- Ngjyrat nuk jane sikur ne foto
- Prapavija eshte kerkuar te jete e zeze ndersa OE e ka ofruar ngjyre teget

Kur analizohet mostra e prezantuar nga ana e OE të rekomanduar për kontratë dhe mostra e autoritetit kontraktues, shihet qartë pa e analizuar në detaje fare që e njëjta nuk është as për së afërmi sipas kërkesës së AK-së. Për ne është e çuditshme se si ka mundësi të rekomandohet për kontratë një OE i cili nuk i ka ofruar mostrat sipas kërkesës së AK-së, ndërsa ne të eliminohemi për një arsye e cila nuk është e qëndrueshme, fare.

Në këtë aktivitet të prokurimit shihen qartë tendencat e AK-së për të rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm, pasi që po përdoren 11/4 standarde të dyfishta kundrejt neve si OE i përgjegjshëm në krahasim me OE të rekomanduar për kontratë. Ngjyrat e prezantuara për mostrën e lartcekur nuk janë as për së afërmi sikurse ngjyrat e mostrës së AK-së. Prapavija e mostrës është kërkuar të jetë e zezë ndërsa OE i rekomanduar për kontratë e ka prezantuar ngjyrën teget. Pra edhe në këtë rast kemi të bëjmë me dallime të mëdha tek mostrat dhe i njëjti OE nuk është dashur të rekomandohet për kontratë sepse nuk i ka prezantuar mostrat sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

5.Logo PK

Mostra e kerkuar nga AK

Mostra e ofruar nga OE I rekomanduar

Mostra Obligative,

Diametri 9 cm , 7 Këndë

Rrethi duhet të jetë I qendisur

Të ketë pjesën tjetër mbrapa VELCRO përfiksim në uniformë .

Emblema të jetë e thurur/ndërlidhur sipas dizajnit me ngjyrë dhe përshkrimit ne foto



PRETENDIMET ANKIMORE

- Dimensioni nuk eshte 9cm
- Ngjyrat nuk jane sikur ne foto
- Kendet nuk jane te drejta dhe nuk kane dimensione te njejta

LOGO e PK-së

Mjafton vetëm të shikohen me sy pa hyrë fare në detaje dhe shihen qartë dallimet që i ka mostra e OE të rekomanduar për kontratë në krahasim me mostrën tuaj. Ngjyrat nuk janë fare si në foto, përkatësisht ngjyra e hirtë.

Po ashtu harta e Kosovës ka shumë dallime në mostrën e OE të rekomanduar për kontratë kur krahasohet me mostrën tuaj si autoritet kontraktues të cilën e keni ofruar. 13/4 Dimensioni i mostrës së lartcekur nuk është 9 cm, ashtu siç është specifikuar tek specifikimet teknike të detyrueshme, mirëpo që çuditërisht autoriteti kontraktues nuk e ka marr parasysh fare këtë fakt.

Këndet e mostrën nuk janë të drejta, ashtu siç janë tek mostra e autoritetit kontraktues dhe njëkohësisht nuk janë me dimensionet të njëjta.

5. Flamuri i Kosovës

Mostra e kerkuar nga AK

Mostra e ofruar nga OE I rekomanduar

Dimensionet: 6 cm me 4.5 cm

Rrethi duhet të jetë I qendisur

Të ketë pjesën tjetër mbrapa VELCRO për fiksim në uniformë .

Flamuri të jetë a thurur/nderlidhur sipas dizajnit me ngjyrë dhe përshkrimit në foto

PRETENDIMET ANKIMORE

- Flamuri nuk eshte I thurur apo nderlidhur sikur foto e Emblemes nga AK
- Dimensioni nuk eshte 4.5cm
- Ngjyrat nuk jane sikur ne foto

Flamuri i Kosovës

Pra edhe në këtë rast mjafton vetëm të analizohen mostrat e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë dhe mostra e prezantuar nga ana juaj dhe shumë lehtë shihen dallimet esenciale ndërmjet mostrave. Ngjyra e flamurit nuk është sipas mostrës tuaj dhe gjithashtu thurja më të cilën është punuar mostra e OE të rekomanduar për kontratë nuk është sipas kërkesës tuaj. Gjithashtu edhe dimensionet e mostrës së flamurit nuk janë 4.5cm ashtu siç është specifikuar në kërkesën e dosjes së tenderit tek specifikimet teknike Për ne është i çuditshëm fakti se si e keni rekomanduar për kontratë një OE të tillë i cili pothuajse asnjërën nga mostrat e kërkuara nuk e ka prezantuar sipas kërkesave të dosjes së tenderit.

Kërkojmë nga ana juaj që ti analizoni në tërësi edhe një herë dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë përkatësisht mostrat e tij dhe të nxjerrni përfundime konkrete, pasi që m të gjitha këto mangësi të OE të rekomanduar për kontratë, nuk mund dhe nuk është dashur të rekomandohet për kontratë ky Operator Ekonomik pasi që i njëjti është i papërgjegjshëm. Vlen të ceket fakti se edhe në tenderin paraprak i cili është anuluar me vendim të OSHP-së, ju e kishit rekomanduar për kontratë po të njëjtin operator ekonomik, i cili kishte qenë i papërgjegjshëm edhe në tenderin paraprak, andaj dyshojmë që përsëri po e favorizoni të njëjtin OE edhe pse i njëjti është i papërgjegjshëm.

Ne pajtohemi me arsyet e AK-së për eliminimin e OE Naim Shuki B.I., pasi që siç edhe e ka konstatuar edhe AK-ja i njëjti është i papërgjegjshëm. Ne me dt.17.11.2023 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim ku AK□ja është arsyetuar se e njëjta është e pa bazuar mirëpo nuk ka dhënë ndonjë arsye konkrete për një refuzim të tillë. Autoriteti kontraktues në vendimin për refuzim i ka përshkruar dispozitat ligjore për të cilat ne kemi ngritur pretendime, duke e cekur se kinse janë respektuar dispozitat ligjore. Ndërsa sa i përket arsyes së eliminimit tonë, e njëjta e ka cekur se tek arsyeja e eliminimit ka pasur një lëshim teknik andaj ne jemi eliminuar me arsyetimin si në vijim: OE mostrën e dorëzuar për Logo K-9 është me ngjyrë të zezë (fjala zezë na ka ik si lëshim teknik). Për këtë arsye të eliminimit autoriteti kontraktues tani në vendimin për refuzim i është referuar Udhëzuesit nr.001/2023 për Prokurimin Publik, përkatësisht nenit 10, në lidhje me specifikimet teknike. Arsyetimi i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm për faktin se ngjyra e prezantuar nga ne për Llogon K-9, nuk është ngjyrë e zezë siç ka pretenduar AK-ja, mirëpo është ngjyrë e kaltërt e mbyllët. Ngjyrat e kaltër e mbyllët ka shumë nuanca dhe nuk është vetëm një nuancë, andaj kërkojmë nga ana e OSHP-së që të analizoj në detaje mostrën e prezantuar nga ana jonë, pasi që ngjyra e mostrës është e kaltërt e mbyllët dhe jo e zezë siç ka pretenduar AK-ja.

Duhet cekur fakti se referimi i AK-së tek dispozita e lartcekur është i paqëndrueshëm, për faktin se ne e kemi prezantuar deklaratën për specifikime teknike, ku kemi deklaruar që do ti përmbushim në tërësi specifikimet teknike. Aneksi 1 nuk ka qenë obligativ që të plotësohet, pasi që edhe nëse do të kishim dashur ta plotësonim, nuk do të kishim mundur pasi që nuk ka ndonjë tabelë ku duhet të shënohet emri produktit ose origjina e mallrave, mirëpo janë të përshkruara vetëm specifikimet teknike

E për këto specifikime teknike ne e kemi prezantuar deklaratën për përmbushjen e specifikave teknike sipas aneksit 1 dhe kjo dëshmi është fakt konkret që ne kemi ofertuar konform kërkesave të dosjes së tenderit, andaj edhe arsyetimi i AK-së është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm. Në lidhje me pretendimet tona ankimore kundrejt OE të rekomanduar për kontratë autoriteti kontraktues i është referuar vetëm njërit nga pretendimet tona përkatësisht i është referuar vetëm madhësisë së shkronjave, duke e cekur se nuk është specifikuar madhësia e

shkronjave tek aneksi 1 dhe njëkohësisht vetëm e ka theksuar se i njëjti OE i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe specifikimet teknike.

Arsyetimi i AK-së shihet qartë se është favorizues për OE të rekomanduar për kontratë, pasi që e njëjta nuk është lëshuar fare në pretendimet tona ankimore të tjera për mostrat e OE të rekomanduar për kontratë. Siç e kemi cekur edhe në kërkesë për rishqyrtim, autoriteti kontraktues sikurse në këtë rast e edhe në aktivitetin tjetër i cili është anuluar, po e favorizon direkt një OE i cili është i papërgjegjshëm dhe njëkohësisht nuk po i merr parasysh fare të metat e mostrave të OE të rekomanduar për kontratë.

Kërkojmë nga ana e OSHP-së që ti analizoj në tërësi pretendimet tona ankimore, për faktin se AK-ja po na diskriminon neve si OE e përgjegjshme dhe njëkohësisht po e favorizon hapur OE të rekomanduar për kontratë, ku edhe pse nuk i ka plotësuar kërkesat dhe specifikimet e dosjes së tenderit, po rekomandohet për kontratë, në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së. Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse ne jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente"

.Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që "Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse", kurse OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm. Gjatë zhvillimit të kësaj procedure nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP, që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE N.T.SH. ''CREATIVE DESIGN" ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në 16/4

RIVLERËSIM dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së. Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore institucionet tjera kompetente.

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

a) Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë nga një mostër për secilin artikull para afatit të fundit të pranimit të ofertave ora 14 : 00.

Dështmia e kërkuar dokumentar.

a) Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë nga një mostër për secilin artikull para afatit të fundit të pranimit të ofertave ora 14 : 00.

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME - në FDT (Dosje tenderit)

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

DEKLARATË

të deklarohet komisioni vlerësues mbi arsyet që e mbështesin këtë rekomandim

Komisioni i vlerësimit pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave për këtë aktivitet i prokurimit , konstatojmë se për këtë pranuar tri (3) oferta , komisioni vlerësues rekomandon si në vijim: t'i jepet kompanisë " RRONI " sepse i plotëson të gjitha kriteret e njoftimin për kontrate, dosje të tenderit, specifikat teknike si dhe është ofertë e përgjegjshme me çmim me i ulët.

B39 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve– procedura e kuotimit te çmimit""

PROCESVERBALI PËR EKZAMINIMIN , VLERËSIMIN DHE KRAHASIMIN E TENDERËVE

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë administrative: përshtatshmërinë e pranushmërisë: përshtatshmërinë pr gjendjen ekonomike dhe financiare: aftësinë teknike dhe / ose profesionale: përshtatshmërinë teknike:

1. **Kompania " RRONI " i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara në njoftimin për kontrate, dosjen e tenderit si dhe specifikacionet teknike** e përgjegjshme me çmim me të ulët.
2. **Kompania " CREATIVE DESIGN " nuk i plotëson Aneksi 1 i specifikacioneve teknike te detyrueshme të dosjes së tenderit** si në vijim: specifikat teknike te detyrueshme te pozicioni LOGO K-9 është kërkuar - Fillimi i rrethit të emblemës me ngjyrë të kaltër e mbyllët - Ope mostrën e dorëzuar për Logo K-9 është me ngjyre te. **Sipas kësaj ky operatore ekonomik nuk i plotëson specifikat e kërkuara ne dosjen eliminohet si ofertë e pa përgjegjshme**
3. **Kompania " Naim Shuki B.I." nuk i plotëson Aneksi 1 i specifikacioneve teknike te detyrueshme të dosjes së tenderit** si në vijim: specifikat teknike te detyrueshme te pozicioni LOGO E POLICISË SË KOSOVËS është kërkuar - Diametri 9 cm , 7 Kënde - Operatori Ekon dorëzuar për Logo e Policisë se Kosovës te diametri i këndeve nuk është ne te gjitha këndet diametri i njëjtë pasi qe diametri është kërkuar ofruar me 8.80 cm. **Sipas kësaj ky operatore ekonomik nuk i plotëson te gjitha kriteret e kërkuara dhe eliminohet si ofertë e pa përgjegj**

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

Operatorit ekonomik është palë e interesit ne procedurë

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi i PSH.OSH nr.2023/0505 , pala ankuese dhe pretendimet ankimore jane te njejtat. Vendim nr.2023/0505 ka bër Anulimi e procedures.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **N.T.SH." CREATIVE DESIGN "**

Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Përgjigje në pretendimi nr. 1

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, bazuar ne aneksin 1 te FDT-se (dosjes se tenderit) , arsyetimi nga OE ankues ne ankesën tij dhe fotografimi i matjeve te mostrave nga vete OE ankues, shihet qarte se te:

LOGO NJSI, IEDD dhe K9, nuk kane diametrin 8 cm, përveç **LOGO NJSO** e cila ka diametrin është 8 cm, prandaj AK – Komisioni i vlerësimit me rastin e eliminimit te OE ankues (është praktik e mire gjate vlerësimit te mostrave te prezantoj fakte dhe dëshmi si p.sh. foto, etj.,,) ka vepruar sipas nenit 59 par. 4 të LPP-së, ku thotë: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

Prandaj, duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika nuk janë të qëndrueshëm. .

Përgjigje në pretendimi nr. 2

Lidhur me pretendimin ne këtë aktivitet te prokurimit te operatorit ekonomik ankues, lidhur me pretendimet se mostrat e dorëzuar nga OE i rekomanduar per kontrate nuk janë as per se afërmi sipas kërkesë se autoriteti kontraktues ne Aneksit 1 te FDT-se, ne kemi vendosur disa dallime te mostrave te OE te rekomanduar per dhënie nga ato te kërkuara nga autoriteti kontraktues.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, bazuar ne dëshmitë, faktet e prezantuara nga OE ankues përmes fotografive me ngjyra vërehen qarte se janë disa dallimesh p.sh.:

TEK LOGO NJSI – ngjyra (por AK ka prezantuar dy logo njëra me ngjyre te gjelbër ushtarake ndërsa, tjera me dy ngjyra qe janë me te hapura), kurse rrethi brendshëm nuk ka qene kërkesë te qëndiset me penj (edhe pse ne specifikim ka qene kërkesë po citoj: "Rrethi duhet jete i qëndisur" pa specifikuar se cili rreth i jashtëm apo edhe rrethi i brendshëm), shkronja vërehen se nuk janë te madhësisë se kërkuar nga autoriteti kontraktues janë më të mëdha;

TEK LOGO NJSO, ngjyrat nuk i posedon sikurse ka kërkuar autoriteti kontraktues ne Aneksin 1 te FDT-së, pasi qe vërehen janë me te hapura, shqiponja vërehër se është shumë e mbyllët nga ajo që ka kërkuar AK, kurse per formën ovale OE ankues nuk ka ofruar dëshmi duke matur gjatës por vetëm përmes fotove që nuk mund te argumentohet ky pretendim;

TEK LOGO K9 – harta është më e madhe se sa kërkesa e autoriteti kontraktues, qeni dallon tek veshët, dhe ngjyra e qenit është ma e mbyllët nuk dallohë/shihën sytë

TEK LOGO e PK-së, tek mostra e prezantuar nga OE i rekomanduar per kontrate, dallon ngjyra, dhe vërehet se hapsira e këndeve është pak sa më engushtë se sa ajo që AK ka prezantuar.

TEK FLAMURI I KOSOVES- tek mostara e prezantuar nga OE i rekomanduar per kontrate, dallon ngjyrat, thurja skajeve te flamurit dallon, si dhe po ashtu dallon ngjyra;

Duke marr për bazë se pretendimet ankimore kanë te bëjnë me mostrat e prezantuar nga OE, atëherë sipas nenit 59 te LPP-se, si dhe nenit 37 te Rregullores nr. 001/2022 per Prokurimi Publik, ku vlerësimi është ne diskrecion te AK-së – sepse eksperti po te shikoj apo inspektoj mostrat atëherë ndërhyn ne përgjegjësin/kompetencat e AK, mirëpo ekspeti bazohet ne faktet dhe dëshmitë e prezantuar nga OE ankues (sqarim: AK te inspektoj me kujdes mostrat dhe te respektoj nenin 59 të LPP-se, dhe nëse asnjë nga OE nuk arrin te kaloj inspektimin e mostrave ashtu siç janë kërkuar nga AK, atëherë te veproj sipas nenit 62 të LPP-së) prandaj eksperti sqaron se AK – komisioni i vlerësimit nuk ka vepruar sipas nenit 59 par. 4 të LPP-së, ku thotë: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe

në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve".

Prandaj, duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë sepretendimi i palës në ankese në këto pika janë pjesërisht të qëndrueshëm.

Përgjigje në pretendimi nr. 3

Lidhur me pretendimin ne këtë aktivitet te prokurimit te operatorit ekonomik ankues,se kur analizohet vendimi per refuzimin e kërkesës per rishqyrtim shihet se AK-ja per secilin pretendim tonin ankimor kundrejt OE te rekomanduar per kontrate .

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, OE ankues përmes platformës elektronike e- prokurim ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim me kurse ZPP i AK-së përmes platformës elektronike e-prokurim nxjerr vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, duke vepruar ne pajtim te plotë me nenin 108/A par. 9 te LPP-se, ku thotë: "Refuzimi do tëarsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë." si dhe nenin 108/A par. 12 te LPP-se, ku thotë: Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesësdhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë", mirëpo bazuar ne vendimin mbi refuzimin e kërkesës per rishqyrtim, nuk janë bindëse dhe as te argumentuar ne gjuhen e fakteve dhe argumenteve - provave apo te bazuar ne dispozita ligjore te LPP-se, por me shume i ngjanë një përshkrimi, duke mos arritur te argumentohet e kundërta e pretendimeve te OE ankues, me fakte dhe argument konkrete dhe bindëse, mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur as nga komisioni i vlerësimit ne raportin e tij dhe as ne vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nga ZPP, andaj duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këto pika janë pjesërisht të qëndrueshëm.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, nuk ka respektuar nenin 7, 59, 60, të LPP-së, andaj Është përgjegjësi, dhe në Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 dhe Aneksin 7 ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke

marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt tëshfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Ne mungesë te provave te paraqiutra lidhur me mostrat e operatorit ekonomik ankues (N.T.SH." CREATIVE DESIGN) ne cilesin e ekspertit shqyrtues nuk mundemi qe te konstatojm se i njeti (O.E N.T.SH." CREATIVE DESIGN) ai ploteson kriterin e mostrave apo jo andaj si rezultat i kësaj edhe rekomandojm qe proecdura te kthehet ne rivlersim.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe rekomandon që të anulohet njoftimit mbi vendimin AK dhe lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **N.T.SH." CREATIVE DESIGN "**

Lulzim Bajrami